
RAPORT MONITORIMI
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT TË
MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
2023

TABELA E PËRMBAJTJES

- Përmbledhje Ekzekutive
- Qasja vlerësuese
- Metodologjia e monitorimit
- Gjetjet e raportit

Objektivi 1: Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të procesit politikëbërës në turizëm dhe mjedis, përmes ristrukturimit organizativ të Ministrisë.

Objektivi 2: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për të përmirësuar standardet e shërbimeve të ofruara nga MTM-ja.

Objektivi 3: Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator me rregulla dhe procedura të qarta dhe transparente për forcimin e etikës dhe integritetit në institucion

Objektivi 4: Rritje e besueshmërisë publike të institucionit përmes përmirësimit të transparencës dhe Ilogaridhënies institucionale, si dhe politikëbërjes me pjesëmarrje të mjedisit dhe turizmit.

Objektivi 5: Forcimi i i rezistencës institucionale për procese/funksione me risk për çënimin e integritetit nepërmjet përmirësimit të mekanizmave dhe masave të kontrollit në procesin e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të politikave dhe projekteve në fushën e mjedisit dhe turizmit.

Konkluzione dhe rekomandime

Hapa të tjera

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

ASPA	Shkolla Shiptare për Administratën Publike
DDLLM	Drejtoria e Derregullimit të Lejeve dhe Licensave dhe Monitorimit
DIKMA	Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës
DKFPM	Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Mjedis
DKFPT	Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Turizëm
DMBNJASH	Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve
DPP	Drejtoria e Prokurimeve dhe Partneriteteve
DPSZHM	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit
DPSZHT	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit
DPSHKRR	Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator
GPI	Grupi i Punës për Integritet
KDI	Koordinatori për të Drejtën e Informimit
KNJKP	Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MVRIIQQ	Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore
PI	Plan i Integritetit
PT	Programi i Transparencës
RKP	Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve
SPIS	Sektori i Përpunimit të Informacionit dhe Statistikave

Përmbledhje Ekzekutive

Lufta kundër korrupsionit është prioritet i qeverisë shqiptare. Angazhimi në forcimin e kuadrit institucional, strategjik, ligjor dhe operacional në fushën antikorrupsion ka çuar drejt hartimit, miratimit dhe aplikimit të instrumenteve konkrete kundër korrupsionit me qasje parandaluese dhe ndëshkuese.

Në vitin 2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në kuadër të zbatimit të nismave antikorrupsion të parashikara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015- 2023, si dhe duke u bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 07.10.2020 hartoi dhe miratoi, Planin e Integritetit të institucionit, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 158, datë 26.04.2022.

Ky dokument përfaqëson përpjekjen institucionale për të prezantuar dhe vendosur një sistem efektiv të menaxhimit të integritetit për periudhën kohore 2022-2025. PI-ja shërben si instrument efektiv për luftën antikorrupsion në nivelin e institucionit duke identifikuar, vlerësuar dhe adresuar risqet që çenojnë integritetin në proceset kryesore të punës së institucionit.

Në Planin e Integritetit të MTM-së janë të parashikuara gjithsej 73 masa të karakterit rregullator e operacional, të cilat konsistojnë kryesisht në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efincencës në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrativedhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë drejtoritë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti është deri në vitin 2025.

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për vitin 2022, është i pari dokument i hartuar që prej miratimit të Planit të Integritetit. Në përputhje me kreun 3, pika 3.1 të Planit të Integritetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hartuar këtë raport monitorimi mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente. Raporti jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për vitin 2022, për statusin e zbatimit të tyre, informacionin për buxhetin, problematikat e hasura në zbatimin e tyre, përmban të dhëna për veprimtarinë operationale të njësisve (drejtorive) të brendshme kontribuese, referuar hartimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator të brendshëm rregullator, burimeve njerëzore dhe profesionale si dhe transparencën dhe komunikimin me grupet e interesuara. Për vitin 2022, Plani i Integritetit ka të parashikuar për zbatim 80 masa/aktivitete, të shpërndara në pesë objektiva, përkatësisht:

Objektivi 1: Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të procesit politikëbërës në turizëm dhe mjedis, përmes ristrukturimit organizativ të Ministrisë.

Objektivi 2: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për të përmirësuar standardet e shërbimeve të ofruara nga MTM-ja.

Objektivi 3: Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator me rregulla dhe procedura të qarta dhe transparente për forcimin e etikës dhe integritetit në institucion

Objektivi 4: Rritje e besueshmërisë publike të institucionit përmes përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies institucionale, si dhe politikëbërjes me pjesëmarrje të mjedisit dhe turizmit.

Objektivi 5: Forcimi i rezistencës institucionale për procese/funksione me risk për çënimin e integritetit nëpërmjet përmirësimit të mekanizmave dhe masave të kontrollit në procesin e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të politikave dhe projekteve në fushën e mjedisit dhe turizmit.

Nga monitorimi rezulton se në totalin prej 73 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për periudhën 2022-2025, rezulton se: janë zbatuar 35 masa/aktivitete, në proces zbatimi kanë mbetur 10 masa/aktivitete dhe 23 masa/aktivitete kanë afatin 2023 e në vijim për t'u zbatuar.

Gjatë vitit 2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit pati një ndryshim stukture dhe organike, të miratuar e urdhërin e Kryeministrit, Nr.128, datë 08.11.2021, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”. Ky akt solli një ndryshim thelbësor në organizimin e institucionit, gjë e cila ndikoi edhe në ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit, referuar masave dhe aktiviteteve të objektivave 1 dhe 2 të tij, që lidhen me plotësimin e vendeve të lira në njësitë (drejtoritë) teknike të ministrisë, përshkrimet dhe elementët teknikë të kryerjes së punës, hartimin e hartës së proceseve të punës. Gjatë vitit 2022, u morën masa të lidhura me përditësimin e rregullores së institucionit. Grupi i Punës i ngritur me Urdhër të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 242, datë 8.8.2022 “Për rishikimin e rregullores së brendshme të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të miratuar me Urdhër nr.420, datë 7.11.2018 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit” hartoi një draft dhe përfshiu në tekstin e saj parashikime mbi kuadrin e plotë rregullator për etikën dhe integritetin, si dhe ndërhyrjet në dispozitat e Rregullores së Brendshme për konfliktin e interesave privatë, dhuratat dhe sponsorizimet, lobistët, veprimtari të jashtëme, sinjalizimin si dhe rregullimin e komunikimit ndërmjet strukturave teknike të brendshme dhe gjithash tu me grupe jashtë institucionit. Por duke qenë se në dhjetor të vitit 2022 u miratua struktura dhe organika e re e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ndryshimet e nevojshme të konstatuara nga Grupi i Punës vlerësoi të rishikoheshin sërish dispozitat e Rregullores së Brendshme, duke u përshtatur me përshkrimet e reja sipas strukturës së miratuar së fundmi.

Ky raport monitorimi evidenton rritjen dhe forcimin e transparencës së institucionit në publikimin dhe njoftimin e kuadrit ligjor, konsultimin publik, raporteve të performancës dhe ato të auditimit (të brendshëm dhe të jashtëm).

Qasja vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përmban një analizë të përgjithshme të kuadrit rregullator mbi aspekte të integritetit në MTM, të performancës institucionale për ti rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështje të transparencës institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të drejtorive dhe strukturave teknike në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të Koordinatorit të së Drejtës së Informimit, një funksion i përcaktuar në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, të Koordinatorit për Informimin dhe Konsultimin Publik. Raporti përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasiore të kontributit të tyre. Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlerësimin institucional të kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre. Analiza sasiore e këtij raporti bazohet në vlerësimin e të dhënave statistikore të strukturave/njësive kontribuese.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatorit i Integritetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinatorit i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme.

Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuese në këtë raport, të cilat janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit;
- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Pëputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis;
- Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse.

Secila njësi ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashkuar për zbatim për periudhën; akte dhe dokumenta të hartuara (verifikueshmëria) e të dhënave; të dhëna për buxhetin; rekomandime dhe konkluzione.

Përpara publikimit, draft-raporti është miratuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit.


Objektivi 1

Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të procesit politikëbërës në turizëm dhe mjedis, përmes ristrukturimit organizativ të Ministrisë

Përmes këtij objektivi synohet adresimi i risqeve dhe faktorët e riskut, të identifikuar në procesin politikëbërës të Ministrisë në të dyja fushat, mjedis dhe turizëm, Risqet e identifikuar në funksionin politikberes të Ministrisë në mjedis dhe turizëm, lidhen me efektivitetin dhe fikasitetin e këtyre proceseve.

Ky objektivi përmban një numër prej 10 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira.

Masat e parashikuara në këtë objektivi, të lidhura kryesisht në kuadër të riorganizimit, nga monitorimi rezultojnë se: 9 masa të zbatuar plotësisht, 1 në proces zbatimi me afat 2023.



Objektivi 2: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për të përmirësuar standardet e shërbimeve të ofruara nga MTM-ja.

Përmes këtij objektivi synohet të adresohen risqet që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin profesional të tyre, të cilat vështirësojnë përpjekjet e institucionit të realizojë proceset e punës me cilësi dhe ofrimin e shërbimeve me standarde.

Ky objektivi përmban një numër prej 17 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira.

Masat e parashikuara në këtë objektivi, nga monitorimi rezultojnë se: 10 masa të zbatuar plotësisht, 3 në proces zbatimi me afat 2023, 4 në proces zbatimi.




Objektivi 3: Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator me rregulla dhe procedura të qarta dhe transparente për forcimin e etikës dhe integritetit në institucion

Objektivi 3 adreson nevojën e institucionit për të patur një kuadër rregullator të plotë në mënyrë që të jetë efektiv duke integruar dispozita të reja ose rifreskuar ato me ndryshimet më të fundit ligjore, kryesisht ato që lidhen me çështje të integritetit të tilla si: Plan i Integritetit, rregulla për garantimin e të drejtës së informimit, mbrojtjes së të dhënave personale, njoftimit dhe konsultimit publik.

Ky objektivi përmban një numër prej 12 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira.

Masat e parashikuara në këtë objektivi, të lidhura kryesisht me ndryshimin e Rregullores së Brendshme, nga monitorimi rezultojnë se: 5 masa të zbatuar plotësisht, 7 në proces zbatimi me afat 2023.



Objektivi 4: Rritje e besueshmërisë publike të institucionit përmes përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies institucionale, si dhe politikëbërjes me pjesëmarrje të mjedisit dhe turizmit

Objektivi 4 synon të adresojë risqet që lidhen me transparencën dhe llogaridhënien institucionale si dhe sigurimin e politikëbërjes me pjesëmarrje. Duke marrë në konsideratë se Programi i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve përfaqësojnë instrumente efektive për transparencë publike të veprimtarisë së institucionit, plani i masave synon rritjen e transparencës përmes plotësisht të tyre.

Ky objektivi përmban një numër prej 17 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira.

Masat e parashikuara në këtë objektivi, nga monitorimi rezultojnë se: 9 masa të zbatuar plotësisht, 4 në proces zbatimi, 4 në proces zbatimi me afat 2023.

Plani i Integritetit



■ Masa të realizuara ■ Masa në proces realizimi me afat 2023 ■ Masa në proces realizimi

Objektivi 5: Forcimi i i rezistencës institucionale për procese/funksione me risk për cënimin e integritetit nepërmjet përmirësimit të mekanizmave dhe masave të kontrollit në procesin e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të politikave dhe projekteve në fushën e mjedisit dhe turizmit.

Objektivi i pestë synon adresimin e risqeve të integritetit në ato procese pune të cilat janë në risk për cënimin e integritetit. Risqet e përfshira janë të karakterit operacional dhe impakti i tyre ishte i natyrave të ndryshme të tilla si: financiar, strategjik, operacional, reputacional dhe të lidhur me informacionin. Masat e parashikuara synojnë forcimin e proceseve monitoruese të dhënies së lejeve dhe licensimit, forcimin e monitorimit dhe komunikimit të progresit në zbatimin e strategjive të sektorëve, planeve të veprimit, forcimin e bashkëpunimit dhe partneriteteve me aktorë të tjerë, lehtësimin e ndarjes së informacioneve ndërmjet institucioneve etj.

Ky objektivi përmban një numër prej 17 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira.

Masat e parashikuara në këtë objektivi, nga monitorimi rezulton se: 1 masë realizuar, 8 masa në proces, 8 në proces zbatimi me afat 2023.

Plani i Integritetit



■ Masa të realizuara ■ Masa në proces realizimi me afat 2023 ■ Masa në proces realizimi

Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit Plan Integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit. Viti 2022, ishte viti i parë i zbatimit të këtij plani integriteti në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Një strukturë e re organizative e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit e miratuar në 3-mujorin e fundit të vitit 2022, ndryshimet referuar strukturës institucionale dhe organikës së ministrisë, mjedisit rregullator, partneritetit dhe angazhimit nga ana e të gjithë njësive teknike afektuan zbatimin e plotë të këtij instrumenti. Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën prill-dhjetor 2022, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezultojnë se: - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit. - Njësitë (drejtoritë) teknike të ministrisë kanë shënuar përparime kryesisht në forcimin e kapaciteteve të stafit, në rishikimin e strukturës dhe në fillimin nga hartimi të paketës së plotë të kuadrit të etikës, integritetit dhe të instrumenteve e mekanizmave rregullatore antikorrupsion. Me urdhër të Kryeministrit nr. 185, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, është miratuar struktura dhe organika e re e MTM.

Hapa të tjera

- Të vijohet me zbatimin e parashikimeve në planin e veprimit;
- Të miratohet rregullorja e re e institucionit, si një detyrë që vjen nga ky plan integriteti dhe të bëhet publikimi i saj në faqen e internetit të MTM;
- Të bëhet informimi/kryerja e trajnimeve të brendshme të stafit të MTM-së për rregullat e integritetit (Kod Etike dhe rregullat e tij);
- Të trajnohen punonjësit përkatës në MTM në lidhje me këtë metodologjinë e re të hartimit të akteve/legjislacionit;
- Të plotësohen vakancat në ministri në të gjithë strukturat ku rezultojnë;
- Të vijohet me hartimin e hartës së proceseve të punës;